REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2022)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Brikena Ukperaj.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për shkak të krijimit të kuorumit dhe të përfshirjes edhe të relatorëve të cilët do të relatojnë në mbledhjen e sotme, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Rendi i ditës ju është bërë me dije dhe vazhdojmë përkatësisht me çështjet përkatëse, duke ia dhënë fjalën relatorit z. Toro për pikën e parë të rendit të ditës.

Zoti Toro!

Alban Toro: Po!-më fal. Dëgjohem?

A dëgjohem?

Ilir Rusi: Po, zoti Toro, dëgjohesh.

Alban Toro: Kisha përshtypjen që ka problem mikrofoni.

Gjithsesi nëse dëgjohem, po vijoj atëherë.

Në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë gjithmonë për plotësimin e vendeve vakante, në rastin konkret, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë për një pozicion të lirë. I vetmi kandidat për këtë pozicion ka qenë znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, aktualisht gjyqtare e skemës së delegimit e caktuar për një periudhë kohe në Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin këto kritere, fillimisht nga ana e Këshillit u pa plotësimi i kritereve formale dhe kritereve të tjera ligjore të kërkuara në aspektin e ngritjes në detyrë.

Kështu që, në këtë kuadër u analizua plotësimi i kriterit të parashikuar nga neni 47/4, 48/8, 8/3 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", konkretisht: "përvoja profesionale minimale", "mospasja e masës disiplinore në fuqi", "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale"; gjithashtu u verifikua "dhënia e pëlqimit nga kandidati dhe familjarët e afërt të tij, për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016; gjithashtu iu bë edhe një verifikim pasurisë dhe figurës. Ndërkohë, me vendimin nr. 368, datë 14.09.2021, nga ana e Këshillit u vendos kualifikimi i kandidates dhe vijimi i procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar.

Ndërkohë, paralelisht vijohen edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional,

dhe konkretisht ato kanë të bëjnë me qëllimin e gradimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016 apo për vlerësimin e vitit 2019.

Me kualifikimin e kandidates znj. {...}, bazuar në pikën 24, të vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve", Këshilli, me vendimin nr. 389, datë 22.09.2021, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në këtë kuadër, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ajo kandidonte, natyrisht edhe për caktimin e relatorit, për të cilin në të dy aspektet ajo nuk pati asnjë lloj vërejtjeje. Kështu që nga ana e relatorit u administrua dosja personale si dhe praktika tjetër dokumentare e procedurës që ka rezultuar e prodhuar gjatë procedurës së verifikimit të plotësimit të kritereve të kandidimit.

Në këtë aspekt, ka rezultuar që me vendimin e Këshillit nr. 392, datë 19.09.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm "Shkëlqyeshëm", duke grumbulluar në total 389 pikë, sipas "Raportit të vlerësimit etik dhe profesional". Gjithashtu me vendimin e Këshillit nr. 183, datë 11.05.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm "Shkëlqyeshëm", duke grumbulluar në total 396 pikë, bazuar kjo në "Raportin e vlerësimit etik dhe profesional". Të dy vlerësimet u administruan, ndërkohë ndaj tyre kandidatja nuk ka paraqitur ankim dhe këtë ajo e ka konfirmuar edhe me një deklaratë të dërguar në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 03.10.2022.

Në kushtet kur këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të parashikuar në Vendimin nr.70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve.

Kështu që, përfundimisht, nga ana e relatorit është redaktuar drafti i vendimit, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1.Znj. {...} (si kandidate e vetme).

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime mbi relacionin dhe projektvendimin përkatës.

Meqenëse nuk ka diskutime, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2022)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Brikena Ukperaj.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

5. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

6. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditës duke ia dhënë fjalën për më tej relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë, relacioni i radhës ka për objekt përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi i hartuar nga ana jonë dhe i propozuar për miratim në mbledhjen e sotme. Pa vonesë po filloj me relatimin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikë dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. nr. 400, datë 07.10.2020, ndër të tjera ka vendosur:

“1. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.”

Në përfundim të procedurës së komandimit, pas shpalljes së bërë me vendimin e cituar më lart, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar vendimit të Këshillit nr. 400, datë 07.10.2020, pas vlerësimit të plotësimit të kritereve të komandimit dhe renditjes së kandidatëve, Këshilli me vendimin nr. 453, datë 19.10.2020, vendosi:

“1. Komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. 2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 20.10.2020.

Gjyqtare {...} më datë 17.10.2021 i paraqiti Këshillit, kërkesën për leje të papaguar për arsye familjare.

Me vendimin nr. 575, datë 07.12.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Miratimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, aktualisht e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 24.12.2021 deri në datë 24.12.2022.”

Aktualisht afati i përsëritjes së komandimit të znj. {...} është në përfundim e sipër, konkretisht më datë 20.10.2022 përfundon afati i komandimit të zonjës {...} dhe prej saj me shkresën nr. {...} prot., datë 12.10.2022 ajo i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ka kërkuar që komandimi i saj si nëpunëse përgjegjëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të mos përsëritet. Pra zonja {...} nuk dëshiron të përsëritet afati i komandimit të saj në Këshillin e Lartë Gjyqësor si nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Propozimi i Komisionit

Për sa më sipër, rezulton të jetë vendi për deklarimin e përfundimit të kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares {...} në fund të afatit të komandimit, referuar vendimit të Këshillit nr. 453, datë 19.10.2020, pikërisht më datë 20.10.2022, sikurse përcaktohet në

pikën 1, të nenit 57, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar”...

Lidhur me të drejtën e magjistratit të komanduar për t’u kthyer në detyrë, sipas pikës 4 të nenit 57 të ligjit 96/2016, Komisioni vlerëson se:

Referuar pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, magjistrati i komanduar gëzon të drejtën që pas periudhës së komandimit të kthehet në pozicionin e mëparshëm, përveçse në rastet kur parashikohet ndryshe në ligj. Duke iu rikthyer rastit të znj. {...}, struktura organike e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, paraqitet në këtë mënyrë:

Organika është me 5 gjyqtarë.

Të emëruar janë mbi organikë, 7 gjyqtarë.

I pezulluar është 1 gjyqtar.

Të transferuar në skemë delegimi, të komanduar janë 2 gjyqtarë.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor, siç e përmendëm, ishte zonja {...}, pra është 1 gjyqtare.

Në detyrë, aktualisht janë 4 gjyqtarë, mungon 1 gjyqtar dhe kjo është vakancë e përkohshme, jo e përhershme.

Në kushtet kur struktura aktuale organizative e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë do ta kishte të pamundur të përfshinte znj. {...} realisht si pjesë e trupës së saj gjyqësore, pasi siç thamë, organika e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është me 5 gjyqtarë. Në këtë rast dhe në këtë situatë të ndodhur, Komisioni propozon që për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Komisioni propozon të shprehemi që zonja {...} të kthehet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, deri në përfundimin e afatit të lejes së parapaguar dhënë me vendimin nr. 575, datë 07.12.2021 të Këshillit, afat i cili përfundon më datë 24.12.2022, pra nuk është vendi që në këtë moment Këshilli të nisë procedurën për transferimin e znj. {...}, për sa kohë zonja {...} ka marrë pikërisht nga Këshilli lejen e papaguar deri më datë 24.12.2022.

Në eventualitetin e kthimit të zonjës {...} në detyrën e magjistratit në përfundim të

afatit të lejes së mësipërme, Këshillit i lind detyrimi që në përputhje me nenet 42 e vijues të ligjit 96/2016 ta caktojë në një pozicion në gjykatë, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm që ajo mbante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin "Nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

Struktura e Projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë të projektvendimit bëhet fjalë për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të znj. {...} në pozicionin "Nëpunës përgjegjës për vlerësimin" në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 20.10.2022, referuar vendimit të Këshillit nr. 453, datë 19.10.2020.

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet kthimi i znj. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, deri në përfundim të afatit të lejes së papaguar të dhënë me vendimin nr. 575, datë 07.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Pra me përfundimin e lejes së dhënë të papaguar Këshillit të Lartë Gjyqësor do t'i lindë detyrimi në atë kohë të nisë procedurat për transferimin e zonjës {...}.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe njoftimi t'i bëhet edhe Gjykatës së Rrethit gjyqësor Lushnjë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime për çfarë u relatua.

Marçela Shehu: Mundem?

Ilir Rusi: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Unë parimisht jam dakord me projektvendimin e paraqitur dhe me ato çka parashtron zoti Kurushi. Kam vetëm një pikëpyetje lidhur me një nga pikat e projektvendimit, konkretisht me kthimin e zonjës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pra në gjykatën ku ka qenë e caktuar përpara se ajo të komandohej pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, por që ndërkohë, ashtu sikurse e relatoi Klodi, aktualisht në strukturën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ka pozicione të lira të përhershme.

Kështu që besoj, domethënë më duket sikur ai kthimi do mbetet vetëm teorikisht. Unë e kuptoj detyrimin që thotë ligji që gjyqtarja duhet të kthehet dhe duhet të disponojë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, por edhe ky kthimi teorik deri në fund të lejes së papaguar mendoj që nuk mund të zbatohet në këtë rast. Pra edhe teorikisht ne nuk mund ta caktojmë gjyqtaren, nuk mund ta kthejmë në një vend që nuk ekziston. Ky është mendimi im.

Si zgjidhje alternative unë do të propozoja që Këshilli ose të fillojë tani procedurat e transferimit për gjyqtaren ose nëse vlerësohet si kohë e papërshtatshme apo kërkon një kohë të caktuar vendimmarrja përkatëse për fillimin e kësaj procedure, atëherë mbase do të ishte më e përshtatshme që Këshilli të shprehej, sikurse e tha edhe Klodi, në fund të periudhës së lejes së papaguar, pra në dhjetor të 2022.

Pra sot Këshilli me të drejtë mund të disponojë për përfundimin e afatit të komandimit të zonjës {...} në Këshill për shkak se afati ka mbaruar dhe ajo nuk ka kërkuar përsëritjen e një komandimi të dytë, por ndërkohë as teorikisht mendoj që nuk mund të disponojmë për kthimin e gjyqtares në një vend, në një gjykatë e cila referuar edhe të dhënave që u paraqitën, në strukturën organizative aktualisht nuk ka një vend të lirë të përhershëm, me qëllim caktimin e gjyqtares {...}.

Besoj që kjo do të ishte alternativa më e mirë që Këshilli në dhjetor të 2022 pra kur gjyqtares t'i mbarojë leja e papaguar, të fillojë (sepse e ka detyrim ligjor patjetër) procedurat për caktimin e gjyqtares në një gjykatë të të njëjtit nivel ku gjyqtarja kishte emërimin e mëparshëm.

Unë kaq kisha.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Dikush nga anëtarët e tjerë ndonjë koment?

Klodian Kurushi: Si relator, më duhet të sqaroj vetëm këtë moment.

Ilir Rusi: Po, patjetër zoti Kurushi. Mendova se mos kishte ndonjë koment nga anëtarët e tjerë dhe pastaj në mënyrë të përmbledhur ta kishit ezauruar. Mendova mos ka ndonjë koment tjetër dhe ta ezaurojmë në mënyrë shteruese komentin si relator.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Kështu mendova unë.

Anëtarët e tjerë kanë ndonjë diskutim?

Alban Toro: Thjesht një argument në favor të vendimmarrjes së Komisionit do të kisha, pasi Komisioni e ka lidhur problemin e emërimit apo caktimit të znj. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vetëm për periudhën e afatit të lejes së papaguar, pra për të pasur të themi një vend pune zyrtar ku kjo gjyqtare të figurojë. Ndërkohë përpos faktit të detyrimit ligjor i cili na detyron për ta emëruar në mënyrë të përhershme në një pozicion tjetër për sa kohë që vendi i punës në këtë gjykatë është zënë, por edhe moralisht na takon që kjo gjyqtare të sistemohet në një vend të përhershëm në një gjykatë, me procedura të cilat do të jenë shumë transparente. Por si në rastin e {...}t, në dijeninë time ka edhe raste të gjyqtarëve të tjerë të cilat do duhet të meritojnë vëmendjen e Këshillit për të bërë sistemimet në strukturat përkatëse, kjo edhe për shkak të formatimit të hartë së re gjyqësore. Kështu që unë mendoj dhe propozoj për ta pasur si detyrim në të ardhmen, jo vetëm si Komision por edhe si Këshill i Lartë Gjyqësor, për të sistemuar dhe për të fiksuar në strukturë të gjithë këto raste të ngjashme, në një kohë sa më të shpejtë që të jetë e mundur, në mënyrë që të mos kemi ekuivoke apo mbivendosje të pozicioneve të gjyqtarëve.

Faleminderit!

Marçela Shehu: Alban, unë e kuptoj shqetësimin e Komisionit që për këtë periudhë, pra deri në përfundim të lejes së papaguar, gjyqtarja të mos mbetet pa një vend pune, por ajo do mbetet pa një vend pune sepse nuk ka, nuk ka pozicion të lirë në Gjykatën e Lushnjës. Këtë po them. Pra mua edhe teorikisht ai kthimi i gjyqtares në Lushnjë nuk më rri sepse është një gjykatë me një strukturë të caktuar me emra të caktuar, ndërkohë gjyqtarja ka mbetur jashtë kësaj strukture. Pra si do ta kthejmë në vendin e punës, kur nuk është vendi i punës?

Prandaj them, nëse ndajmë të njëjtin mendim, të fillojmë tani procedurat e caktimit të gjyqtares në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, ose nëse nuk jemi gati, atëherë për sa kohë gjyqtarja nuk afektohet edhe në aspektin buxhetor sepse është me leje të papaguar, le t'i bëjmë këto procedura në dhjetor, por thjesht nga ana juridike nuk më rri që ne t'i themi të kthehet në një vend pune i cili në fakt nuk ekziston më për gjyqtaren.

Gjithsesi ky është mendimi im. Këtë ta vlerësojë Këshilli. Thjesht mbetet për t'u vlerësuar pastaj nga secili.

Ilir Rusi: Pra ju zonja Shehu, me atë çfarë ju parashtroni, mendoni se duhet të hiqet pika 2 e projektvendimit: "2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, deri në përfundim të afatit të lejes së papaguar të dhënë me vendimin nr. 575, datë 27.12.2021 *(data e saktë 07.12.2021)* të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Marçela Shehu: Po, ky do të ishte propozimi im, që mbase është edhe më i përshtatshëm për momentin, për të mos vështirësuar procedurat sot për Këshillin. Gjithsesi, nëse Këshilli e vlerëson ndryshe, pra që duhet ta caktojë në një gjykatë gjyqtaren, atëherë i bie që të fillojmë procedurat e caktimit të gjyqtares në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel. Por propozimi im fillestar është që të hiqet pika 2, pra përfundimi i periudhës së komandimit, ndërsa për caktimin pastaj Këshilli të shprehet në përfundim të lejes së papaguar.

Ilir Rusi: Që do të thotë, me përfundimin e periudhës së komandimit vazhdohet një "statu quo", që gjyqtarja është me leje të papaguar deri në dhjetor të 2022-shit. Ky është koncepti. Ndërkohë që, në gjykatën mëmë që ajo ka qenë, nuk ka më vende pune

për 5 gjyqtarë, për 4 gjyqtarë - për ta bërë më të thjeshtë situatën - sepse atje janë 4 gjyqtarë dhe nuk ka vend për një të pestë. Kjo është ideja. Përderisa nuk ka vend për një të pestë, atëherë ju mendoni që ne të shprehemi për përfundimin e periudhës së komandimit pa përcaktuar në pikën 2 kthimin e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë për faktin sepse nuk ka vende të lira, por të vazhdojë "statu quo"-ja e lejes së papaguar deri në dhjetor dhe Këshilli paralelisht të fillojë procedurat për transferimin. Kjo është ideja juaj zonja Shehu?

Marçela Shehu: Po, po! Po zoti Rusi, kjo ishte ideja.

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi, që e kërkuat fjalën.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Për të sqaruar edhe një herë situatën.

Kam përshtypjen se të gjithë kolegët janë të dakordësuar bashkërisht në përfundimet që kemi nxjerrë dhe ato çfarë propozon zonja Shehu nuk bien fare në kundërshtim me konkluzionet e arritura si nga relatimi që bëra ashtu edhe nga projektvendimi. Neve e thamë dhe unë po vazhdoj të insistoj dhe ta përsëris. Zonja {...} ndodhet në një leje të papaguar dhe për këtë është marrë një vendim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Njëkohësisht, situata e dytë ishte situata që asaj i mbaron afati i komandimit brenda datës 20.10.2022. Meqenëse zonja {...} ndodhet në këto dy lloj situatash, e para që i mbaron afati i komandimit dhe e dyta, ajo ndodhet në një leje të papaguar, ne kemi detyrim ligjor që të shprehemi për këto dy situatat e sotme. Detyrimi vjen si rezultat i institutit të komandimit. Pra Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të shprehet në një vendim deklarativ, që zonjës {...} t'i konstatojmë përfundimin e afatit të komandimit dhe ky është një detyrim ligjor. Referuar ligjit, që edhe zonja Shehu e përmendi, gjyqtarja kthehet në pozicionin e mëparshëm të punës ku ushtronte funksionet e saj si gjyqtare.

Tani, çfarë ndodh në rastin konkret, që e bën pak më specifik?

Nëse zgjonja {...} nuk do kishte marrë lejen e papaguar, atëherë Këshilli në këtë moment do t'i lindte detyrimi, siç e kemi thënë edhe në relacion në përmbajtjen e tij, që së bashku me konstatimin e përfundimit të afatit të komandimit, të niste procedurën për

transferimin e saj (është e thënë, referuar nenit 42 e vijues të ligjit "Për statusin"), duke i dhënë mundësi përzgjedhjeje të vendeve të tjera të të njëjtit nivel, që Këshilli do ia ofronte zonjës {...}, sipas përcaktimeve të nenit 42 e vijues të ligjit 96/2016. Por nuk ndodhemi në këtë situatë sot. Pse? Sepse zonja {...} ka marrë një leje të papaguar deri në fund të dhjetorit të vitit 2022.

Ndodhur në këto kushte, duke marrë në konsideratë edhe këtë rrethanë të re që i referohet rastit të marrjes së lejes së papaguar, ne si Këshill kemi konkluduar që fillimisht të konstatojmë përfundimin e afatit të komandimit të zonjës {...} dhe në mënyrë deklarative të respektojmë edhe dispozitën konkrete ligjore që zonja {...} të shkojë në vendin e mëparshëm të punës. Por duke marrë në konsideratë edhe rrethanat e tjera që janë leja e papaguar dhe organika mbi numrin e kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në përmbajtje të relacionit e keni të cituar duke të thënë që zonja {...} në përfundim të afatit të lejes së papaguar do t'i ofrohet mundësia për t'u transferuar sipas procedurave që ndjek transferimi referuar nenit 42 e vijues të ligjit 96/2016. Dispozitivi i propozuar nga ana jonë, në këtë rast, kur themi "kthimin e gjyqtares" (pika 2), që besoj që ka edhe kontestime, në formë, se në përmbajtje jemi të gjithë dakord me ç'kuptova, "kthimin e zonjës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë", nuk e përfundojmë këtu fjalinë, por themi më tej "deri në përfundim të afatit të lejes së papaguar të dhënë me vendimin nr. 575". Pse deri në përfundim? Sepse në momentin që do përfundojë afati i lejes së papaguar, është po ky Këshill që duke marrë në konsideratë kriteret ligjore, të organikës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (që është mbi organikë), e ka të pamundur që ta transferojë/ta çojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë zonjën {...}, por duhet të nisi procedurat, është detyrim i Këshillit, për të nisur procedurat për transferimin e saj, duke respektuar rregullat e transferimit. Kjo është arsyeja pse unë mendoj që dispozitivi në këtë rast duhet të lexohet i integruar edhe me pjesën e përmbajtjes së relacionit. Në relacion jemi shprehur qartë, që në përfundim të afateve zonjës {...} do t'i nisin procedurat e transferimit në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel me të njëjtën gjykatë që ajo ka ushtruar paraprakisht funksionet e saj si gjyqtare.

Ky është edhe mendimi ynë në lidhje me ato momente dhe çaste që unë mendoja se duheshin sqaruar për të gjithë anëtarët e Këshillit. Faleminderit!

Irena Plaku: A ta marrë unë fjalën?

Ilir Rusi: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Me sa kuptova unë dhe shqetësimin e Marçelës, që është i drejtë (shkëputet audio)

Dritan Hallunaj: Hape mikrofonin se e ke mbyllur.
Ilir Rusi: Zonja Plaku të lutem!

Irena Plaku: Ah, më fal.

Ilir Rusi: Mund ta filloni nga fillimi parashtresën se nuk u dëgjuat.
Po zonja Plaku, fjala për ju.

Irena Plaku: Atëherë, me sa kuptova shqetësimin e zonjës Marçela, kuptova që caktimi i saj, i magjistrates {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është i pamundur për shkak se organika është mbi organikë dhe nuk ka vend të lirë pune, që në një situatë normale zonja {...} nuk do caktohej në rast se ne do vendosnim përfundimin e komandimit të saj pranë Këshillit, në situatën që kjo e fundit do të ishte në punë dhe nuk do ishte me lejen e papaguar e cila i është dhënë me vendim të Këshillit. Kjo është situata normale që do përfitonte. Në këtë rast zonja {...} ndodhet me leje të papaguar por përsëri gëzon statusin e gjyqtares. Duke qenë me statusin e gjyqtares, kemi detyrimin të caktojmë këtë gjyqtare, pavarësisht se është me leje apo me leje lindje apo çfarëdo leje tjetër që mund të përfitonte, ne duhet ta caktonim në gjykatën të cilën është e mundur caktimi i saj. Meqenëse nuk janë bërë procedurat për arsyet e cituara nga ana e relatorit për caktimin e saj në kushtet kur është me leje të papaguar, do ishte edhe më e drejtë që ne mos të merrnim një vendim për caktimin e saj në Gjykatën e Lushnjës por të lihet pa caktuar, derisa të fillonte procedura që të vijojmë përcaktimin e saj në një gjykatë të ngjashme me gjykatën përkatëse ku ajo është caktuar më parë. Kështu që, po e mbështes mendimin e Marçelës, pasi edhe në rastin që ne do ta caktonim, do vinim në një situatë

tjetër më pas, që zonja {...} do të jetë caktuar në një gjykatë mbi organikë dhe më pas nuk do të jetë më në kuadrin e gjyqtares të cilës është caktuar nga pozicioni i komanduar në një pozicion në gjykatën... është rikthyer tashmë në gjykatën e vendit të saj dhe më pas për transferimin e saj do zbatohen të gjithë procedurat për transferimin e çdo gjyqtari tjetër. Kështu që mendoj që është e vlefshme... mbështes propozimin e Marçelës për sa kohë që nuk sjell asnjë pasojë në radhë të parë që ne mos të shprehemi në këtë moment.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, për më tej hedh në votim propozimin e zonjës Shehu.

Zonja Shehu ju jeni që në projektvendim të hiqet pika 2 e saj.

Klodian Kurushi: Edhe një koment të lutem, ka mundësi? Përpara se të marrim...

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Atëherë, edhe për një sqarim të vogël për mendimin e Komisionit.

Ne menduam që nuk bën sens që gjyqtarit t'i mbarojë mandati i komandimit dhe të qëndrojë pa gjykatë. Me mbarimin e afatit të komandimit është ligj, gjyqtari kthehet në vendin e mëparshëm të detyrës. Nuk mund të rrijë gjyqtari pa gjykatë.

E dyta, caktimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë aktualisht është mbi organikë, është shkak ligjor i parashikuar në nenin 42 e vijues të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve", që Këshilli të nisë procedurat e transferimit. Një nga rastet e nisjes së procedurave të transferimit të gjyqtarit është rasti kur organika e një gjykate ka një numër më të madh gjyqtarësh sesa numri që duhet të përmbajë ajo gjykatë sipas organikës së miratuar. Kështu që, në këtë pikë, po i mëshoj fort, gjyqtari pasi kthehet nga skema e komandimit nuk mundet të rrijë pa gjykatë. Dhe e dyta, referuar rastit të transferimit, është rast tipik transferimi, kur organika e gjykatës ka në përbërje të saj gjyqtarë mbi numrin e lejuar, hapen procedurat e transferimit. Kjo është arsyeja pse e kemi vendosur dispozivin e tillë në pikën 2, që derisa zonja {...} ka paraqitur një kërkesë dhe është marrë një vendim nga Këshill në fund fare

për një leje të papaguar, ne themi që në përfundim të lejes së papaguar, zonjës {...} do t'i nisin procedurat për transferimin e saj nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë për shkak të pozicionit mbi organikë të saj në këtë gjykatë. Edhe në hipotezën nëse zonja {...} do kthehet nesër apo pasnesër në detyrë, që në atë moment, pra ta thyej lejen e vendosur me vendim të Këshillit, në atë moment Këshilli dhe Komisioni ka detyrimin ligjor të nisë procedurat menjëherë për transferimin e saj në një gjykatë tjetër. Kjo është arsyeja ligjore e transferimit, prandaj ne mendojmë që pika 2 i jep kuptim jo vetëm projektvendimit por edhe relacionit që është bashkëlidhur me këtë projektvendim. Faleminderit!

Marçela Shehu: Mundem?

Ilir Rusi: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Atëherë, unë kam përshtypjen që nëse unë dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mendojmë njëlloj, pra trajtimi që është bërë në relacion nga Komisioni është i drejtë, pra aty parashtrohet e gjithë situata faktike që ekziston si për gjyqtarin edhe për gjykatën. I vetmi dallim në koncept është që unë mendoj që as teorikisht sot nuk mund ta kthejmë gjyqtaren, qoftë edhe në mënyrë të përkohshme në gjykatë ku nuk ka një pozicion të lirë për gjyqtaren, ndërkohë që Komisioni thotë që po, ne teorikisht mund ta kthejmë qoftë edhe përkohësisht (sepse të dy ndajmë të njëjtin mendim), pra që nuk mund të shkojë në një gjykatë që nuk ka vend, Komisioni thotë që po, edhe përkohësisht ne gjyqtaren, derisa t'i përfundojë leja e papaguar, mund ta caktojmë në një gjykatë që s'ka vend. Mua në këtë moment mendoj që ndahem nga Komisioni. Pra në thelb, i gjithë parashtrimi i shkon logjikës sime, por në fund mua nuk më rri fakti që qoftë edhe përkohësisht këtë gjyqtare ne ta kthejmë përkohësisht në një gjykatë ku s'ka vende.

Lidhur me atë shqetësimin që thotë zoti Kurushi që Këshilli ka detyrimin që ta caktojë gjyqtarin në një pozicion sepse ne nuk mund të përfundojmë komandimin dhe ta lëmë gjyqtarin pa një vend, unë e mirëkuptoj prandaj dhe në fillim të fjalës sime unë paraqita dy propozime alternative: propozimi i parë ishte që për sa kohë zonja {...} është me leje të papaguar dhe nuk afektohet situata e saj financiare, ne mund t'i marrim me nge

procedurat e transferimit, por nëse Këshilli mendon që jo, kjo nuk është zgjidhja më e mirë, por ne duhet sot të marrim një vendim dhe ta lidhim gjyqtaren me gjykatën, atëherë le të nisim menjëherë procedurat për transferimin e gjyqtares në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel. Pra edhe për mua është shqetësim kjo gjë. Por për prakticitet dhe për t'i dhënë kohë vetes për të kuptuar diçka më shumë edhe për shkak të riorganizimit që po ndodh, thashë që për sa kohë situata buxhetore e gjyqtares nuk cenohet, sepse nëse do cenoheshe duhet patjetër t'i fillonim sot procedurat e transferimit për ta nisur në një gjykatë tjetër sepse Lushnja s'do e paguante dot, por për sa kohë kjo pjesë e saj nuk afektohet, unë propozova që ta heqim pikën 2 dhe këtë gjë ta mendojmë në dhjetor. Nëse Këshilli nuk pranon, sigurisht që jam dakord që t'i nisim sot procedurat për transferimin dhe gjyqtares t'i caktojmë një vend të përhershëm në një gjykatë të të njëjtit nivel.

Këtë koment e bërë që mos të ketë keqkuptime me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës. Në thelb gjërat i mendojmë njëlloj. Është thjesht çështja e qasjes lidhur me pozicionimin e gjyqtares për këtë periudhën provizore. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë, për më tej fjalën...

Dritan Hallunaj: I nderuar Zëvendëskryetar, nëse mundem?

Ilir Rusi: Zoti Hallunaj, po patjetër!

Por më duket se e ka kërkuar fjalën përpara zonja Luli, në të kundërt vazhdoni zoti Hallunaj.

Fatmira Luli: Atëherë, unë do nisem nga ai shpjegimi i fundit, që ne në përfundim të afatit duhet detyrimisht të bëjmë transferimin e zonjës {...}. Atëherë, nëse në këtë moment zonja {...} nuk do ishte me leje ne do të mund ta çonim dot {...} në Gjykatën e Lushnjës? Kjo është pyetje për Klodin.

Klodian Kurushi: Po, faleminderit zonja Luli.

E thashë, në një situatë normale, nëse zonja {...} nuk do ishte me leje por do ishte në Këshill e komanduar, në përfundim të procedurës që i referohet afatit të përfundimit të

komandimit. Zonja {...} do të transferohej referuar nenit 42, pika 3, germa “b” e ligjit “Për statusin e gjyqtarit”, me argumentimin/shkakun ligjor që i referohet ndryshimeve në strukturën administrative, pasi zonja {...} do të ishte mbi organikë, pra në numrin 7 (nga numri 5), duke marrë në konsideratë edhe këtë rrethanë, ne do vijonim procedurat sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 42, pika 3, germa “b” të ligjit, për ta transferuar zonjën {...} në një gjykatë të të njëjtit nivel me atë që ajo ushtronte funksionet më përpara. Por e thashë që nuk jemi në një situatë krejtësisht normale sepse ne si Komision kemi marrë në analizë, kemi vlerësuar edhe vendimmarrjen që kemi marrë bashkërisht për dhënien e lejes së zonjës {...} deri në dhjetor të vitit 2022, si leje e papaguar, dhe ky kriter tjetër/kjo rrethanë tjetër është marrë në konsideratë nga ana jonë për të përgatitur relacionin dhe projektvendimin përkatës.

Për të hequr çdo shqetësim, ndoshta edhe çdo dyshim që mund të ketë çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, po vazhdoj të insistoj dhe ta deklaroj dhe ta them, sikundër e kemi thënë edhe në relacion, Komisioni së shpejti, brenda afatit të lejes do marri të gjitha veprimet e nevojshme dhe do propozojë përpara Këshillit transferimin e zonjës {...} në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel me atë që ka ushtruar ajo funksionet përpara se sa të përfshihej në skemën e komandimit, sepse kjo zgjidhje që propozojmë është një detyrim ligjor i parashikuar në nenin 42.

Afati, sa shpejt? Unë mendoj që do ta bëjmë shumë shpejt. Por ditën e nesërme nuk më shkon, domethënë nuk mund të them që nesër do përgatisim relacionin e radhës për t’i dhënë tre alternativat zonjës {...} sepse marrim në konsideratë edhe faktin që ajo është me leje të papaguar, pra marrim në konsideratë vendimin që e kemi miratuar të gjithë së bashku. Kjo është përgjigjja ime. Nuk e di sa i qartë isha, sa i plotë, për pyetjen që bëri zonja Luli.

Faleminderit!

Fatmira Luli: Faleminderit zoti Kurushi!

Argumentat që më dhatë më bindin akoma më shumë që ne nuk kemi pse shprehemi për caktimin e saj në Gjykatën e Lushnjës, por gjatë kohës që ajo vazhdon të jetë me leje, ne duhet të shprehemi që duhet të përfundojë procedura e transferimit të zonjës në një gjykatë tjetër. Kështu që ne s’kemi pse bëjmë një vendim formal, që në

thelb është nul, për arsye se ajo është me leje të papaguar, dhe e dyta e çojmë në një gjykatë që nuk ka vend pune. Për të dyja arsyet ne bëjmë një vendim të ndërgjegjshëm që është fiktiv, ndërkohë që duke zbatuar ligjin ne themi që derisa ajo të mbarojë lejen të niset procedura e transferimit dhe ajo përfundon besoj në përfundim të lejes. Kështu që jam dakord me propozimin e Marçelës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Luli!

Zoti Hallunaj, keni kërkuar fjalën!

Dritan Hallunaj: Faleminderit i nderuar Zëvendëskryetar!

Atëherë, shkurt se i kemi thënë disa herë, edhe nga kolegët u tha dhe u stërthanë. Ndodhemi në kushtet që ka përfunduar afati i komandimit në Këshill i gjyqtares/magjistrates znj. {...}, i përfundon në datën 20.10.2022. Kemi edhe një vendimmarrje tonën që ka leje të papaguar deri në datën 07.12.2022. Pra e gjithë ideja apo problemi qëndron se çdo bëhet me këtë për periudhën nga 20.10 deri në 07.12.2022. Atëherë, meqenëse kjo është me leje të papaguar për këtë periudhë, e dyta, meqenëse këtu ne nuk mund ta mbajmë dot më pasi përfundon ky afat, statusi i saj do mbetet pezull. Logjika është do kthehet në vendin e origjinës. Duke u kthyer në vendin e origjinës, na rezulton që nuk ka vend, atëherë pse mos të bëjmë një lëvizje tjetër: të përfundojë afatin e kohëzgjatjes, pra të shprehemi; ta kthejmë zonjën {...} si magjistrate në një gjykatë tjetër (mund ta kthejmë në Fier, në Vlorë ose në Berat) ku ka një vend të lirë dhe kjo do jetë periudhë pastaj që do na shërbejë, deri në datën 7 dhjetor, do na shërbejë ne dhe asaj për të zgjedhur tre vendet që mund t'i ofrojmë ne, dhe përfundon situata e tillë. Ajo nuk është këtu. Nuk paguhet nga asnjë vend se është me pa të drejtë page dhe normalisht nuk ka as bllokim pagash për Gjykatën e Lushnjës dhe vazhdon normalisht procedura. Ne këtu jemi për të menaxhuar sistemin dhe mundet që në kuadër të lëvizjeve të menaxhojmë edhe këtë situatë, duke e kaluar atje. Këtu nuk do mund të rrijë ajo. Po situata e saj, të rrijë në Lushnjë, do rrijë në ajër ajo? Prandaj unë propozoj, duke komunikuar edhe me Komisionin që t'i propozohet një vend në Gjykatën e Shkallës së Parë në Vlorë, në Fier apo në Berat, ku ka një vend të lirë, dhe të shkojë, të paktën të ketë emërimin si magjistratë aty në atë vend. Deri më datë 7 dhjetor siç thashë, kemi përfunduar çdo

veprim në lidhje me këtë gjyqtare.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Atëherë, keni diskutime të tjera?

Po, zoti Hado, keni për të diskutuar?

Ridvan Hado: Po! Unë jam dakord me propozimin e zonjës Shehu.

Për sa kohë që vendi i punës i zonjës {...} në Gjykatën e Lushnjës është i zënë, ne s'mund të bëjmë emërim fiktiv. Kështu që, le ta zgjidhim problemin e transferimit të saj deri në përfundimin e lejes së papaguar të saj. Me një fjalë jam dakord me heqjen e pikës 2 nga projekti.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Irena Plaku: Mund ta marrë...?

Ilir Rusi: Urdhëro!

Urdhëro zonja Plaku!

Irena Plaku: Shumë shkurt.

Meqenëse është tek diskutimi për sa kohë që ne nuk mund ta lëmë në një gjykatë. Jam dakord edhe me propozimin e z.Hallunaj, por për të eliminuar çfarëdo lloj gjëje, tek pika 2 mund të shtojmë mund të shtojmë edhe një gjë tjetër: "Fillimin e procedurës për caktimin e gjyqtares në një pozicion", që Këshilli të marrë masat për caktimin e saj. Besoj se do jetë e përshtatshme. Gjithsesi ta vlerësojë karriera *(Komisioni)* më mirë.

Marçela Shehu: Mundem?

Dritan Hallunaj: Unë thjesht kam një pyetje.

Nëse ne bëjmë një veprim të tillë, ku do i shënohet kësaj gjyqtareje/ magjistrate periudha nga data 20.10.2022 – 07.12.2022, pra cila do të jetë qendra e punës tek libreza e punës?

Fatmira Luli: Është e papaguar.

Nuk i quhet vjetërsi leja e papaguar.

Dritan Hallunaj: Dakord. Po në cilin vend? Se ajo do figurojë diku, se ka një shkëputje. Nuk është në Këshill, nuk është me emërim në gjykatë. Ku ndodhet? 'Pending'.

Fatmira Luli: Me leje.

Dritan Hallunaj: Edhe një herë zoti Zëvendëskryetar.

Propozoj këtë, që shikojeni këtë mundësinë e një emërimi apo e një emërimi të përkohshëm në një gjykatë të një niveli të barasvlershëm me këtë të Lushnjës, që i bie Fier, Vlorë, Berat, dhe mendoj që situata është e zgjidhur. Ky është mendimi im. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Po, zonja Shehu, çfarë kishit për të thënë?

Marçela Shehu: Unë doja të thoja këtë, që Këshilli ka pasur më përpara raste të ngjashme. Tani nuk mbaj mend mirë emra, por kam përshtypjen ka qenë rasti i zonjës {...}. Zonja {...} për një kohë të gjatë nuk ishte e lidhur me një gjykatë, pavarësisht se gëzonte titullin e magjistratit dhe Këshilli i filloi procedurat dhe në përfundim të procedurave të transferimit dhe pasi i ofroi edhe tre pozicione të lira gjyqtares, më në fund, pas realizimit të procedurës së saktë, e caktoi përfundimisht në një gjykatë gjyqtaren. Çka dua të them, që ky nuk është rasti i parë që gjyqtarja, për një kohë shumë të shkurtër, të mund të mbesi edhe pa caktimin fiks të vendit të saj.

Gjithsesi, unë e thashë që në fillim të fjalës dhe po e përsëris (dhe mbase po

bëhem përsëritëse në atë që po them). Unë e kuptoj shqetësimin e Komisionit, edhe të zotit Hallunaj edhe të zotit Kurushi, e kuptoj edhe logjikën e ligjit që gjyqtarja në momentin e përfundimit të komandimit duhet të lidhet me një gjykatë, atëherë, nëse nuk pranohet dhe nuk bën sens propozimi që deri në fund të lejes së papaguar ajo të mbetemi pa u shprehur, ndërkohë të vijojmë me procedurën e transferimit, atëherë le të jetë pikërisht ky vendim ku ne të disponojmë për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtares. Nga ky moment Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe më pas Këshilli vihet në lëvizje për ta caktuar gjyqtaren në një pozicion. Por nuk mund ta bëjmë sot them unë. Pra ne nuk mund të komunikojmë tani me gjyqtaren dhe t'i themi, ne kemi caktuar këto tre vende dhe tani zgjidh se ne do të caktojmë. Pra ne nisim procedurën, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e trajton, bën procedurën përkatëse, i ofron vendet, merr pëlqimin/miratimin e gjyqtares dhe pastaj vjen në Këshill me një propozim lidhur me caktimin përfundimtar të gjyqtares në një pozicion. Pra nëse nuk jemi dakord që ne ta lëmë pa u shprehur për gjykatën ku gjyqtarja do të caktohet, atëherë le të disponojmë në vendim si një pikë të dytë të tij që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës fillon procedurat për transferimin e gjyqtares {...}. Tani më duket se u thanë të gjitha.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, duke e nisur diskutimin tim nga ajo çfarë thatë ju në fund "që u thanë të gjitha", unë vlerësoj se propozimi juaj në thelb është që, duke marrë në konsideratë projektvendimin që na është paraqitur, të hiqet pika 2 e saj dhe në projektvendim të ngelet pika 1 dhe pika 3, dhe njëkohësisht do doja të vlerësoja faktin që meqenëse edhe ne jemi në pjesën e riorganizimit të gjykatave për shkak të hartës së re gjyqësore, mund të ketë edhe gjykata që mund të kenë gjyqtarë mbi strukturën përkatëse që lejohet për të pasur një gjykatë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kështu që unë mendoj që t'i bashkëngjitem propozimit të bërë nga zonja Shehu, që në projektvendimit që na është paraqitur, të hiqet pika 2 e saj dhe të ngelet vetëm pika 1 dhe pika 3. Meqenëse ky ka ardhur si propozim i parë, ftoj anëtarët e Këshillit për votimin e propozimit të zonjës Shehu, duke u hequr pika 2 e projektvendimit përkatës që është paraqitur.

Fatmira Luli: Atëherë, duhet korrigjuar, se propozimi ishte më ndryshe, ishte

nisjen e procedurave të transferimit.

Ilir Rusi: Atëherë, zonja Luli, po ta dëgjojmë me kujdes, zonja Shehu përsëri është në mbledhje ende. Tha që fillimisht do propozoj që të hiqet pika 2 e saj.

Zonja Shehu edhe një herë.

Marçela Shehu: Atëherë, e thashë në fillim, e thashë edhe në vijimësi të mbledhjes. Kur propozova që pika 2 të hiqet ishte më shumë për efekte praktike dhe për sa kohë nuk e afektojmë situatën financiare të gjyqtares, dhe t'i japim kohë vetes, për shkak edhe të riorganizimit, që të kuptojmë më mirë situatën ku jemi dhe të procedojmë më pas me periudhën e transferimit. Ky është propozimi im i parë. Nëse ky propozim për Këshillin...

Ilir Rusi: Edhe një herë të lutem, artikuloje propozimin zonjë Shehu, që ta mbajmë.

Marçela Shehu: Propozimi im i parë është që pika 2 e projektvendimit të hiqet.

Ilir Rusi: Ok, faleminderit!

Marçela Shehu: Nëse ky propozim pa pikën 2 nuk gjen mbështetjen e Këshillit, atëherë unë do të propozoja si variant të dytë, si propozim të dytë, që pika 2 e projektvendimit të zëvendësohej me parashikimin që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës nis procedurat e transferimit për gjyqtaren. Këto janë dy propozimet e mira, por që si propozim të parë kam heqjen e pikës 2 nga projektvendimi.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Do të shtoja, meqenëse edhe ju parashtruat atë çfarë thatë, që brenda tetorit, grupi i hartës do përcjellë aktet përkatëse edhe për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në to do dalë e qartë se cila është struktura e tyre për shkak të

riorganizimit të disa gjykatave, dhe duhet parë edhe numri i gjyqtarëve minimal që duhet për çdo gjykatë dhe çfarë ka më tepër në raport edhe me funksionalitetin dhe ngarkesën e tyre. Kështu që, pas këtij komenti do ftoj Këshillin për votimin e propozimit të parë të zonjës Shehu, duke u hequr pika 2 e projektvendimit.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Dakord me propozimin e dytë të Marçelës, jo të parin. Jam kundra për këtë.

Ilir Rusi: Domethënë jeni kundër të parit, për t'u hequr pika 2.

Fatmira Luli: Jam për të dytin, që të hiqet pika 2 siç është dhe të thuhet "të nisin procedurat e transferimit deri në përfundim të afatit të lejes së papaguar.

Ilir Rusi: Që do të thotë je kundër propozimit të parë për t'u hequr pika 2 dhe të mos zëvendësohet me asgjë. Je kundër kësaj.

Fatmira Luli: Jam kundër kësaj që të hiqet dhe të lihet pa gjë. Jam me propozimin e dytë.

Ilir Rusi: Po pra zonja Luli, domethënë je kundër propozimit të zonjës Shehu që të hiqet pika 2 e saj dhe të zëvendësohet me diçka tjetër. Për këtë jeni. Pra je kundër propozimit të zonjës Shehu që të hiqet pika 2, por të zëvendësohet me diçka tjetër. Kjo është ideja.

Fatmira Luli: Po!

Ilir Rusi: Megjithëse kjo ishte pjesë e një votimi të dytë. Dakord.

Fatmira Luli: E bëra sqarimin.

Ilir Rusi: Zonja Rupa!

Marçela Shehu: Dakord, për procedurë.

Ilir Rusi: Po, patjetër Marçela.

Marçela dakord me propozimin.

Yllka Rupa: Unë shpreh dakordësinë për propozimin e parë të zonjës Shehu. Në lidhje me propozimin e dytë të zonjës Shehu unë mendoj që në një mbledhje tjetër ... (ka

shkëputje audio e zonjës Rupa)... të ketë kohën e nevojshme për të disponuar mbi propozimin e dytë të zonjës Shehu. Kështu që unë shpreh dakordësinë vetëm për propozimin e parë të zonjës Shehu. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Përpara se të shpreh mendimin tim në lidhje me dy propozimet e zonjës Shehu, po them edhe një herë shkurtimisht, se nuk dua të lodh asnjë nga kolegët. Për propozimin e parë për heqjen e pikës më bën non sens që të dali dispozitivi i projektvendimit me dy pika të pandërthurura me njëra-tjetrën. Ndërsa për detyrimin, që është propozimi i dytë, për të përfshirë si pikë në vendimin tonë që do marrim, detyrimin e Këshillit për të filluar procedurat e transferimit, më lejoni t'jua them, në relacionin e paraqitur nga ana jonë në faqen 3 të relacionit, në paragrafin e dytë është shprehur e zeza mbi të bardhë që me përfundimin e afatit të lejes së mësipërme, Këshillit do t'i lindi detyrimi që referon neni 42, pra detyrimin për ta transferuar zonjën {...} në një gjykatë sipas rregullave që i referohen institutit të transferimit. Prandaj them në këtë rast, nuk bën sens që çdo konkluzion që ne kemi arritur në përmbajtjen e relacionit që ia kemi dërguar mbledhjes, ta shënojmë edhe si pjesë të dispozitivit çdo konkluzion të relacionit. Ajo është e thënë, është pjesë e relacionit, është pjesë integrale e projektvendimit që ne kemi çuar sot për miratim. Pra edhe meraku apo shqetësimi që duhet ta vendosim në dispozitiv fillimin e procedurës është e thënë në relacion. Faleminderit!

Pra jam kundër propozimeve dhe i qëndroj propozimit që kemi sjellë ne si Komision. Faleminderit!

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e parë të zonjës Shehu për t'u hequr pika 2.

Kështu që, në përfundim të votimit rezulton se me 5 (pesë) vota pro miratohet propozimi i zonjës Shehu, për t'u hequr pika 2 nga projektvendimi përkatës. 4 (katër) vota janë kundër.

Atëherë, pas këtij votimi, projektvendimi i paraqitur kthehet në vendim por me këtë përmbajtje:

Vendim "Për përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 20.10.2022.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.10.2022)

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor", në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:25 dhe mbaroi në orën 12:29.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Brikena Ukperaj.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit, Drejtoria e Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

3. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, Përfaqësuese EWMI-INL.

6. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor", në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022".

Ilir Rusi: Për më tej kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit përkatës z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Siç jeni në dijeni, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 28.9.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 187...", si dhe me vendimin nr. 627, datë 28.9.2022 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave", ka ndryshuar niveli i pagave për punonjësit e sistemit gjyqësor, si për magjistratët ashtu edhe për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë.

Efektet e këtyre ndryshimeve janë shtrirë që nga data 1 shtator 2022.

Në zbatim të këtyre vendimeve, si dhe në vijim të vendimit nr. 388, datë 19.09.2022, "Për transferimin (rishpërndarjen) e fondeve buxhetore në programin 03310 në shpenzime korrente, për vitin 2022", të Këshillit të Lartë Gjyqësor, struktura

përgjegjëse për administrimin e buxhetit pranë KLGJ-së në bashkëpunim me gjykatat, ka realizuar një analizë të plotë të gjendjes së fondeve buxhetore, duke u mbështetur në realizimin e deritanishëm të buxhetit pra në shtator 2022 si dhe në realizimin e pritshëm deri në përfundim të vitit buxhetor 31 dhjetor 2022, në programin 03310, në shpenzime korrente, pra në buxhetin e gjykatave, duke u mbështetur në artikujt 600, 601, 602 dhe 606. Ne këtë analizë e kemi mbështetur në informacionin e sjellë nga 38 gjykatat e të gjitha niveleve; në evidentimin e fondeve të lira në të katër artikujt që sapo citova (600, 601, 602 dhe 606), për çdo gjykatë; evidentimin e efektit financiar të përllogaritur për periudhën e sipërcituar për të gjitha gjykatat.

Fonde të lira në 03310, në shpenzime korrente rezultojnë në këto vlera:

- Në artikullin 600 – 1,640,000 lekë;
- Në artikullin 601 – 8,300,000 lekë;
- Në artikullin 602 – 5,400,000 lekë;
- Në artikullin 606 – në vlerën 2,800,000 lekë.

Nevojat e paraqitura gjatë analizës nga disa gjykata për fonde shtesë për të përballuar efektin e rritjes së pagave dhe në zbatim të këtyre VKM-ve, të sipërcituara, i kemi sipas artikujve buxhetor të mëposhtëm:

- Në artikullin 600 – nevojat janë 14,930,000 lekë;
- Në artikullin 601 – shpenzime sigurime, janë në vlerën 1,610,000 lekë.

Gjatë kryerjes së analizës kanë paraqitur nevoja për fonde shtesë në shpenzime operative dhe Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Këto kërkesa argumentohen me rritjen e aktivitetit të këtyre gjykatave, rritjen e çmimit të karburantit, rritjen e numrit të çështjeve të gjykuara, dhe si rrjedhojë rritjen e shpenzimeve operative, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me rritjen e shpenzimeve për shërbime printimit, shpenzime karburant, shërbime për avokatë kryesisht, ekspertë, etj.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pasi mori në shqyrtim dhe miratoi relacionin e përgatitur nga Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes (transferimin) së fondeve buxhetore të lira, në shpenzime korrente, në

artikullin 600, 601, 602 dhe 606, në programin 03310, Buxheti gjyqësor, sipas pasqyrave të mëposhtme nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, të cilat të gjithë i keni përpara.

Ju falënderoj për vëmendjen! Në pritje të ndonjë pyetjeje ose sugjerimi. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z. Haxhiu!

Ftoj anëtarët e Këshillit nëse kanë diskutime apo pyetje për çfarë u parashtrua nga relatori.

Nëse nuk ka diskutime, kalojmë në votim.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor", në shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2022".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) së fondeve të lira në programin 03310 "Buxheti Gjyqësor", në shpenzime korrente (artikulli 600, 601, 602 dhe 606), për vitin buxhetor 2022, sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Ditë

të mbarë.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor